

INTERVISTË ME OMER SHKRIJELIN

Janjevë | Data: 11 qershor, 2019

Kohëzgjatja: 56 minuta

Të pranishëm:

1. Omer Shkrijeli (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Anita Susuri (Intervistuesja)
4. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: A mund të na tregoni ndonjë gjë për fëmijërinë tuaj, çka ju kujtohet?

Omer Shkrijeli: Po duke pasur parasysh që kam lindur në Bresovc, kohë më parë në vitin 1959, fëmijëria ime ka filluar në fakt në Lipjan, sepse si tre vjeçar, do të thotë me tri vjet kam ardhur në Lipjan sepse babai ka punuar në milicinë e atëhershme dhe ata si formacion gjysmë ushtarak kanë pasur për zakon shpërnguljen, që të zhvendosen sipas risistemimit dhe komandantëve të tyre. Dhe atëherë kur kemi ardhur '63-tën në Lipjan, u vendosëm aty dhe pastaj ka mbaruar ajo zhvendosja sepse policia u transformua në, milicia u transformua në polici dhe pastaj aty... dhe ajo çka më kujtohet, ajo që më kujtohet nga fëmijëria ime është në fakt e lidhur me Lipjanin.

Do të thotë ajo e para, përshtypjet e para ishin se ai ishte një vend i vogël, relativisht intim, jemi njohur shumë me njëri-tjetrin. Por duke shikuar nga ky aspekt, nga kandvështrimi i sotëm Lipjani ka qenë totalisht ndryshe atëherë. Ka qenë më i vogël dhe ka qenë i populluar me njerëz që nuk ishin nga Kosova, që është shumë interesante, sepse rrethi i Lipjanit ka qenë i tillë, që ka pasur shumë miniera, shumë fabrika. Pastaj ata mjekët e parë, mësuesit e parë, të gjithë janë dërguar aty me detyrë që të shërbejnë në Lipjan. Dhe pastaj aty mbeteshin me familjet e tyre. Nga ajo anë ka qenë pak interesante, edhe ai shoqërimi, sikur të ishit në një Jugosllavi të vogël të atëhershme (qesh).

Dhe jemi shoqëruar. Pastaj bashkëqytetarët tonë shqiptarët relativisht vonë kanë filluar të vendosen në Lipjan, sepse kuadrot kanë arritur vonë. E vetëm kur universiteti ashtu, ka filluar të punoj vullshëm në Prishtinë në vitet '68 deri '70. Atëherë ngadalë edhe ajo infrastruktura ka ecur, dhe është përshtatur me situatën demografike. Dhe pastaj ato, ato shoqërimet e mia kanë qenë shumë të lidhura për aty, për ata shokët e mi, fëmijët e atyre inxhinjerëve, mjekëve. Kemi luajtur lojëra të ndryshme të cilat sot vetëm mund të përmenden, tani janë harruar, ka faj elektronika normalisht. Po, tash luajmë vet, nuk na nevojitet shoqëria (qesh).

E pastaj kur kemi, kur filloi ajo përzjerja, lëvizja e popullsisë. Pastaj kam pasur shokë të mrekullueshëm, edhe shqiptarë, kështu që kjo është arsyeja pse unë e flas shkëlqyeshëm gjuhën shqipe, sepse që kur kam qenë i vogël, kështu pa kurrfarë kompleksi. Madje me dëshirë, sepse jam edhe tip i tillë. Gjëra të reja kam dëshirë t'i mësoj (qesh) dhe t'i njoh dhe madje ka qenë kënaqësi që më shumë kohë të kaloj edhe për shkak të gjuhës edhe për shkak të kulturës tjetër me të cilën nuk jam mësuar deri atëherë, të shoqërohem me moshatarët e mi dhe me komunitetin shqiptar.

Pastaj ka qenë ashtu e zakonshme... ai shteti i atëherëshëm, ja sot dikush po e lavdëron, dikush fajëson. I ka pasur disa përparësi, e ka favorizuar atë bashkëjetesën, nëse jo diçka tjetër, të paktën kemi aktruar që jemi bashkë (qesh) dhe pastaj aty ka pasur shkëmbim të përvojave. Atë që unë e di i tregoj miqve të mi, atë që e dinë ata unë e marr prej tyre. Pastaj i kemi pasur ato shoqërimet sportive, unë diku nga e pesta, e gjashta klasë e shkollës fillore, do të thotë si njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë vjeçar kam qenë aktiv, i kyçur në disa shoqata sportive. Kështu që, unë isha më i suksesshëm në shigjetari. Kështu që, kam pasur rezultate të shkëlqyera, ku diku në shkollë të mesme kam arritur të bëhem edhe kampion i Kosovës, pra në pushkë ajrore (qesh).

Pastaj jam njoftuar edhe me, pastaj me mirënjohurën, Sanije Hysenin. Ajo që, nëse ju, nëse keni. Ka qenë një përfaqësuese e rinisë sonë nga Kosova madje ka qenë e nderuar që t'ia dorëzoj shtafetën¹ Titos. Edhe ajo ka qenë një e re shumë e suksesshme atëherë, dhe është marrë me shigjetari, kështu që kjo, për mua ka qenë hajt të themi, kremi i shoqërisë. Ato shoqatat sportive. Unë shpesh i krahasoj me sot, sot nuk ka të tilla, sot shoqërohem në vende të tjera dhe dëshirojmë ta arrijmë imazhin në një mënyrë tjetër. Atëherë ka qenë shumë sport i favorizuar, kjo edhe më ka pëlqyer, në sistemet e atëherëshme. Kështu që të themi diku në fund të shkollës fillore dhe në fillim të së mesmes kam filluar edhe me ushtrimet aktive për atletikë.

Edhe aty kam pasur mjaft sukses, kam qenë shumëngjyrësh, i kam disa medalje poshtë në shtëpi. Kam shkuar atëherë në ato [garat] federale, në kampionate shtetërore. Dhe atëherë ka qenë ajo, që vazhdimisht të ndryshohet republika. Kam shkuar edhe në Ohër, dhe në Kladovo {lëviz duart} dhe Budva, pastaj Umag, do të thotë shëtitesh dhe e njofton një vend dhe pastaj si ferial.² Lidhja feriale³ keni dëgjuar se ka ekzistuar, dhe kjo ishte një organizatë e cila i ka mbledhur të rinjtë që dëshirojnë ta njohin botën dhe të udhëtojnë nëpër botë. Nuk janë dashur shumë para, çdo qytet e ka pasur Lidhjen feriale, nëse nuk keni për hotel, lajmëroheni te Lidhja feriale, keni akomodim dhe ushqim falas dhe pastaj kjo për rininë ka qenë shoqërim i shkëlqyer.

¹ Shtafeta e cila është mbajtur për ditën e rinisë më 25 maj dhe e kalonte gjithë Jugosllavinë, për nder të ditëlindjes së liderit komunist Tito.

² Person i ri që udhëton me ndihmën e organizatës *Ferijalni Savez*.

³ Në gjuhën serbe: *Ferijalni Savez*, Organizata që i mbledhte të rinjtë, i edukonte, i dërgonte në udhëtime dhe ju siguronte ushqim dhe akomodim.

Kështu që, edhe në atë mënyrë e kemi pasur mundësinë ta njoftojmë atë shtetin që ka qenë atëherë aq i madh. Dhe desha të ndërlihem aty se në këtë mënyrë e kemi shkëmbyer edhe atë kulturën, pasurinë kulturore. Kështu që, atëherë ka qenë shumë normale që të gjithë ta dijnë të paktën një këngë nga vendet e atëhershme [të Jugosllavisë], dhe do këndonin me rend, fillo nga Maqedonia, Kosova e më tutje, kush çka ka ditur. Dhe kjo gjithmonë ka tingëlluar bukur dhe të paktën është dukur bukur... Pastaj filluan studimet. Studimet i kam regjistruar në vitin '78, do të thotë viti i parë i shkollimit ka qenë '78-'79. Kam përfunduar '84-tën.

Erëmirë Krasniqi: Këtë në Prishtinë?

Omer Shkrijeli: Në Prishtinë, po.

Erëmirë Krasniqi: Si ka qenë në Prishtinë atëherë?

Omer Shkrijeli: Po ka qenë, ka qenë mirë. Ka qenë mirë, mendoj se nuk do të ishte e drejtë nëse do të thosha që nuk ka qenë mirë, sepse ka qenë mirë. Sepse shumë ligjerata i kemi mbajtur bashkë me kolegët me grupin shqiptar dhe çka e ka plotësuar kështu që të themi, unë edhe pse jam në grup me serbo-kroatët, në gjuhën serbo-kroate, i kam pasur profesorët shqiptarë që në të njëjtën mënyrë i kanë mbajtur ligjeratat për të gjithë, ashtu njëjtë profesorët nga Beogradi kanë mbajtur në grupe edhe në shqip edhe serbisht. Kështu që, aty janë shkëmbyer përvojat nga më shumë universitete. Ja të themi, më kujtohet atëherë Musa Haxhiu të themi ka qenë eksperti më i shquar nga fusha e fiziologjisë, edhe njëri edhe tjetri pastaj ai Osmani, Izedin Osmani nga mikrobiologjia.

Po ku ta di, ka aty që mund t'i përmendi edhe disa kuadro të tilla të fuqishme që atëherë fare nuk është, atëherë nuk ka pasur pengesa se kush nga vjen. Pastaj kemi qenë në situatën që bash, të pasurohemi shpirtërisht dhe shkencërisht të përsosemi. Fakultetin gjithashtu e kam kaluar me lehtësi, mendoj lehtësisht sa i përket kohës sepse shumë nuk kam, humbur as kohë as vite dhe kam diplomuar '84-tën dhe atëherë detyrë e jona ka qenë të mësojmë e shteti na punësonte menjëherë, do të thotë ka qenë e ndarë (qesh). Nuk është dashur të vraposh, sa për ilustrim, ka qenë e enjte kur kam diplomuar ndërsa të hënën kam filluar të punoj.

Ja, kjo është një ëndërr. Unë ju flas tani fëmijëve të mi, kjo është diçka si film i vizatuar (qesh) ata nuk mund ta kuptojnë sepse ashtu edhe ka qenë. Dhe pastaj...

Erëmirë Krasniqi: Sa i përket qytetit të Prishtinës, a ju kujtohet si është ndërtuar në atë kohë?

Omer Shkrijeli: Po, kanë qenë disa hajt, unë shpesh i thërras uniforma, të komunizmit disa ndërtesa. Nuk janë ato të shëmtuara por kanë qenë funksionale, e për kushtet e sotme nuk kanë qenë aq të bukura. Ja i keni lart në Aktash ato ndërtesat, ato të kuqe e të bardha, po tani pak janë {ngrit duart} rregulluar ato fasadat. Janë ato mbi universitet, ato blloqet, {tregon drejtimin} nëse e vëreni, do të

shihni. Aty janë tullat, shtyllat e betonit, aty janë teracat që ngjasojnë me njëra-tjetrën dhe nga jashtë çdo gjë është dukur si kuti, që të ketë më shumë hapësirë brenda. Kjo kërkohet, sepse të themi atëherë, në sistemin e atëhershëm punëtori pas një përvoje të punës ka pasur të drejtë që nga shteti ta fitoj atë banesën.

Pastaj banesat kanë qenë të kategorizuara, nga ato një dhomshe, dy dhomshe, tri dhomshe pastaj kur martoheshit, e fitoni një dhomshe, bëheni me fëmijë, shkoni në dy dhomshe dhe kështu me rend kurse ate e lirojmë, e lirojmë banesën për më të rinjtë. Do të thotë nuk kemi pasur banesa personale atëherë por shteti ka dhënë në bazë të madhësisë së familjes dhe kontributit në punë. Atëherë është matur, është shikuar. Dhe pas përfundimit të studimeve kam filluar normalisht të punoj, atë stazhin e detyrueshëm. Kam punuar pak kohë në shtëpinë e shëndetit, pak në klinikë.

Erëmirë Krasniqi: Në Prishtinë?

Omer Shkrijeli: Po, në Shtëpinë e Shëndetit në Lipjan kam punuar, jam pranuar në punë, kurse stazhin në klinikë. Atëherë është dashur çdo klinikë të vizitohet, të punohet një pjesë e stazhit sepse kemi qenë mjekësi e përgjithshme. Do të thotë është dashur të dimë për gjithçka nga pak. Pastaj vijnë ato obligimet tona klasike, e dini, ne meshkujt është dashur të sakrifikojmë një vit edhe për ushtri, kemi qenë në shërbim ushtarak. Por për vete konsideroj që nuk ka qenë një humbje për mua sepse në kohën e shërbimit ushtarak, gjashtë, shtatë muajt e parë kam qenë në një edukim të veçantë në AMU, Akademinë Mjekësore Ushtarake.

Kështu që, përkrah kështu mjeksore, lëndëve, atje i kam kaluar edhe trembëdhjetë lëndë taktike si ushtar, që të mund të isha në një strukturë të ushtrisë së atëhershme si, një lloj komandanti. Dhe mirë, e gjithë kjo është dukur bukur sepse për mua ka qenë mirë nga ajo ana profesionale. Aty i kisha të gjithë profesorët, profesionistët eminent, dhe sot AMU është një institucion i njohur. Dhe pastaj si stazhist, si ai oficeri rezervë, kam qenë në Ljublanë diku gjashtë muaj dhe atje kanë qenë kushtet e shkëlqyera për punë. Edhe sot e kësaj dite ata janë shumë para neve.

Ndonjëherë është ajo ndjenja e keqe - pse nuk qëndrova. Por ne në jug e dojmë më shumë familjen se sa një karrierë të mirë (qesh) dhe kthehemi në shtëpi. Dhe ajo ka kaluar, ai vit.

Erëmirë Krasniqi: E çka tjetër ju kujtohet nga ajo periudhë?

Omer Shkrijeli: Kjo është ajo, ato janë ditët e zakonshme të ushtrisë, prapë fqinjët. Aty janë mbledhur njerëzit nga të gjitha anët. Edhe pse kam hasur në një periudhë e cila, e cila nuk më ka gëzuar aq. Ka filluar aty tashmë të, ashtu të krijohej distancë ndërmjet njerëzve, tashmë kishin filluar të ndahen njerëzit, atëherë kanë qenë edhe ato vitet jo shumë të mira për shqiptarët e Kosovës. Kur kanë filluar të vdesin në ushtri, ndoshta ju kujtohet, ndoshta ju kanë treguar, ju jeni të rinj, kjo është. Unë të themi në vitin '86 kur unë kam shkuar në ushtri, kur jam kthyer rreth vitit '93, '94 shqiptarët e rinj janë vrarë në

ushtri. Kinse rastësi, kinse rastësi. Do të thotë është dashur që, gjithmonë të mendohet për këtë, a është i rastësishëm numri aq i madh.

Pastaj ka qenë ai rasti Kelmendi dhe kështu, kështu që kam, për neve nga Kosova nuk ka qenë aq e këndshme, është dashur gjatë gjithë kohës të bëjmë disa biseda informative dhe të shpjegoni që ju nuk jeni pjesë e atij tregimi, që askush nuk po ju ngacmon dhe kështu e kështu. Sido që të jetë, për mua, fokusi ishte më shumë në vetë punën dhe prandaj kam pak anekdota nga jeta e përditshme. Unë kam dashur pak të jem, nuk kam dashur të jem në atë mainstreamin e kohës së atëhershme, por pak më shumë le të shkoj {bën me dorë} kush dëshiron më tutje, vetëm të mos më prek. Dhe ndër tjera kjo ka ndikuar që, kur jam kthyer nga ushtria ta zgjedh këtë vend të punoj sepse poshtë është institucion i madh, Prishtina edhe më e madhe, gjithmonë do të jem në rrugë të dikujt.

Duke pasur parasysh që jam boshnjak nga vendi që, do të thotë nuk jam nga këtu, nuk kam këtu ndonjë familje të gjerë që ta kem atë përkrahjen sublime por më mirë ka qenë që unë pak të largohem edhe pse atëherë, për standardet e atëhershme kam qenë shumë premtues. Kam qenë ndër dymbëdhjetë studentët më të mirë të vitit. Ja sa për ilustrim, kemi punuar bashkë edhe me Afrim Blutin, dhe me këtë të njohurin Jusuf Ulaj, ky Kelmend Pallaska, ata janë gjenerata ime. Sepse ne kemi punuar bashkë atëherë dhe kanë pritur nga unë që t’iu bashkangjitem, të ju them të drejtën (qesh).

Dhe ka qenë befasi që unë kam mbetur në shtëpi të shëndetit, thjesht një, të paktën jam kursyer nga ato përplasjet, përplasjet e mundshme që më vonë ka dalur që janë të vërteta. Kanë pësuar shumë njerëz që kanë dashur të jenë, ja që të luftojnë. Nuk ka qenë kohë e tillë dhe kjo më ka sjellë në Janjevë. Aty ka qenë kjo, aty sapo ishte ndërtuar kjo ndërtesa e re në Janjevë.

Erëmirë Krasniqi: Në cilin vit ka qenë kjo?

Omer Shkrijeli: ‘88-tën më 17 nëntor është hapur, është dita e çlirimit të atëhershëm të Lipjanit dhe atëherë, atëherë unë e kam pranuar këtë vendin e punës kurse në maj të vitit ‘89 do të thotë në vitin kur e gjithë kjo është renovuar, kur i kanë futur gjërat, atëherë kam ardhur këtu edhe të punoj edhe të jetoj.

Anita Susuri: E si ka qenë Janjeva?

Omer Shkrijeli: Po Janjeva ka qenë interesante. Kanë jetuar diku pesë deri në gjashtë mijë kroat, turq dhe shqiptarë por kryesisht edhe romë. Kryesisht ajo që ka qenë më interesante për mua, njeri i ri, në çdo vend kanë qenë shokët, këtu kanë qenë zotërinj. Të themi, vij, njeri i vjetër dhe, “Zotëri doktor”, apo ku ta di, prit, ngadalë në atë kohë ne, apo, “Hajde shok” apo ajo “Hajde shoqe” kështu por tani përnjëherë kam ardhur në një vend sikur ta kisha lënë atë shtet (qesh). Dhe e dyta, ka pasur edhe shoqërimi shumë më shumë se në vende tjera. Kështu që, e kam pasur përshtypjen që e gjithë Kosova ka dashur të shlirohet, të argëtohet, të vijnë këtu në Janjevë dhe të kaloj mirë (qesh).

Sepse, siç thonë tonët, është ngrënë, është pirë, është kënduar, {lëviz duart} janë argëtuar, nga mëngjesi deri të nesërmen. Do të thotë këtu nuk ka pasur orar të punës por këtu edhe organet qeverisëse kanë lejuar që gjithçka të jetë e hapur deri në mëngjes, nuk ka mbyllje (qesh). Kështu që, të shumtë janë shoqëruar në çarshi. Dhe ka qenë zakon të themi, që nëpër shtëpi në vizita nuk kanë shkuar. Unë për shembull të vij në shtëpi te ju e ju të vini te unë, por takohemi në çarshi. Kurse, gratë janë vizituar mes vete. Kështu që, ka pasur pak (qesh) ndarje nga ai këndvështrim. Dhe ka qenë shumë interesante.

Anita Susuri: Ku keni dalë më shumë? Cilat kafiteri kanë qenë?

Omer Shkrijeli: Po ajo, ajo ka qenë atëherë, tani shumica janë mbyllur. Ka qenë, bash më kujtohet, i kemi numëruar njëherë, kanë qenë nëntë kafiteri dhe dymbëdhjetë kafiqa. A mund ta paramendoni? Për këtë vend aq të vogël. Do të thotë aq shumë rini ka pasur dhe të gjitha kanë qenë të mbushura. Kurrë nuk keni qenë të sigurt që do të keni vend (qesh). Të gjitha kanë qenë të mbushura sepse shumë njerëz, familjet kanë qenë, këtu ka qenë normale që një familje t'i ketë shtatë, tetë, nëntë fëmijë. Kjo ka qenë...

Erëmirë Krasniqi: Te kroatët?

Omer Shkrijeli: Te kroatët, po. Sepse kjo me siguri vjen nga feja katolike, ata i ndalojnë abortet dhe i ndalojnë ndaljet e shtatëzënive në çfarëdo mënyrë dhe kështu që familjet kanë qenë ashtu, me shumë njerëz. Që, që ka bërë që një vend kaq i vogël të ketë shumë njerëz. Kur shikoni, kjo është e tëra, {lëviz dorën} për disa hapa jeni te, në cilën do pjesë. E keni vërejtur, rrugët e ngushta, shtëpitë afër njëra tjetrës, e në secilën shtëpi plot fëmijë. Do të thotë, kanë jetuar, po them, ndërmjet pesë dhe gjashtë mijë njerëz këtu.

Anita Susuri: Kur ju keni ardhur këtu, e keni pasur tashmë familjen apo?

Omer Shkrijeli: Jo, jo. Këtu jam, martuar dhe po them, këta janë dy faktorë që më kanë sjellë këtu, ai që kam thënë, që pak t'i largohem atyre konflikteve të cilët janë paraqitur, dhe që tashmë kanë qenë të paraqitur, atëherë ka qenë ai shtatori i famshëm, kur i larguan kuadrot shqiptare, kuadrot shqiptare nga të gjitha publike, institucionet publike. Dhe pastaj, ka qenë viti '90 dhe unë disi jam kapur para atyre viteve '89-'90, do të thotë e kam ndjerë që diçka nuk do të shkoj mirë, dhe thashë më mirë e kam këtu. E faktori tjetër është, jam martuar, e secilës grua të re i pëlqen të jetë vetëm me bashkëshortin. Dhe pastaj, hajt pse të shkoj në shtëpinë familjare, këtu po ofrohet banese komode.

Dhe pastaj, kështu jam nisur aty dhe kam mbetur deri, deri sot, për shkak të rrethanave sepse disi prej atëherë e deri sot, asgjë e mirë nuk ka ndodhur. Gjithmonë janë disa konflikte, gjithmonë me vështirësi, disa trazira. Çka ishte e mira nga koha e atyre luftërave ballkanike? Ky vend po zhduket,

praktikisht po zhduket. Sepse edhe vet shqiptarët, ata e thonë këtë pa kurrfarë kompleksi, “Janjeva ka qenë Janjevë deri sa kanë qenë kroatët”. Edhe tani është ajo Janjeva.

Erëmirë Krasniqi: A mundeni pak më shumë rreth kësaj, si ka qenë Janjeva në kohën kur ju keni ardhur? A ju kujtohet ajo atmosfera më ndryshe?

Omer Shkrijeli: Paj po them, atmosfera kështu, ja t’ua shpjegoj një ditë ndoshta do të jetë ky ilustrim më i mirë se si është dukur Janjeva. Për shembull zgjoheni kurdo në mëngjes, kurrë nuk keni qenë i pari në çarshi, gjithmonë ka qenë dikush. Kryesisht kanë qenë amviset të cilat, jo në oborrin e tyre, por ka qenë zakon që secila rrugën para derës së shtëpisë, do të thotë rrugën publike ta pastroj, ta laj. Dhe atëherë ka mbisunduar kalldërma, por ajo e periudhës turke, e vendosur me duar. Që do të vizllonte në atë diellin e mëngjesit, bash është, e gjelbrimi {lëviz dorën} shumë gjelbrim dhe disi e plotësonte, e pasuronte peisazhin.

Ka pasur shumë gjelbrim edhe këtu, {lëviz dorën} nëpër çarshi. Tani po mbizotëron ky betoni për shkak të ndërtimit dhe kjo. Ka pasur shumë, madje edhe disa degë nga tarraca ime kanë arritur (qesh). Dhe dilni, ashtu, të mbushur me një freski, të mbushur me një freski dilni në çarshi, ta pini kafën e mëngjesit, e atje kafenetë tashmë të mbushura. Tashmë dikush ishte aty. Ka pasur aty punëtorë të “Metalikut”, punëtorë që punonin në Prishtinë, autobusi shkonte në gjashtë e gjysmë që këtu, do të thotë nga ora gjashtë, ka qenë. Dhe unë kam dashur gjithmonë edhe atëherë të dal, edhe kur është ora gjashtë, kur janë të gjithë aty. Diçka ndodh, pak bëjmë shaka dhe pastaj punëtorët kush ku. Unë e hap ordinancën dhe pacientët e dinin, as nuk është dashur t’i pres këtu.

Nëse jam në kafe, më thërrasin, unë vij këtu. Ka qenë zakon të më thërrasin edhe në shtëpi për kontroll, kështu që edhe atje kam shkuar, në vizita shtëpiake. Dhe po them, çdo gjë është dukur disi bukur, kemi kaluar bukur. Qendër e shoqërimit gjithmonë ka qenë kisha lartë, sepse ata janjevasit kanë qenë shumë të lidhur me të veten, me kishën e vet. Kështu që, gjërat më të rëndësishme, kur flitet për ja për shembull, mjekët, mësuesit gjithnjë kanë qenë të kyçur në ato planet infrastrukturore. Çfarë do të kërkojmë nga komuna, çka do të kërkojmë nga krahina? Hajde të merremi vesh e të na e ndërtojnë.

Dhe pastaj kjo ndodhte lart te kisha. Vij unë si mjek, vjen dikush prej këtyre njerëzve të arsimuar, mësuesit apo kushdo. Pastaj, formulojmë atë interesin e një vendi çka do të ishte më e mirë dhe më e përshtatshme, që për hir të së mirës, për të mirën e të gjithë banorëve. Pastaj pas një kohë fillon edhe aty të, të shpërthejnë gjërat.

Erëmirë Krasniqi: Si kanë qenë shtëpitë atëherë?

Omer Shkrijeli: Po mundeni edhe gati në mënyrë autentike t’i inçizoni edhe këto tash, që janë, vetëm se janë rrënuar e atëherë kanë qenë të freskëta, të bukura, fasada është riparuar çdo pranverë. Kështu

ka qenë zakoni që në pranverë të gjithë të lyejnë, do të thotë pa përjashtime. E keni parë, zakonisht kanë lyer bardh, kjo është dukur shumë bukur, në krahasim me ato tjegullat që janë lart në, në kulm. Është ajo tjegulla e vjetër turke, më vonë kanë filluar të blihen ato pllakat (qesh). Dhe kështu, shtëpitë edhe pse janë dukur të rrënuara në shikim të parë, kanë qenë solide, kanë qëndruar shumë.

Dhe ka qenë aty, po edhe sot janë ato, një shembull i mirë është ajo kulla nga guri, do ta shihni diku në drejtim të jugut. Ajo është diku 300 vjet e vjetër, i ka takuar një familjes Cirimotiq edhe ata i kanë pasur disa të tyre, por tani është e boshatisur. Janë ndërtuar, janë ndërtuar nga, nga materiali që ka qenë këtu. Nga guri, ata qerpiçë⁴ nga dheu, apo nga materiali që ata vet e kanë prodhuar. Kanë pasur mjeshtër të shkëlqyer. Mjeshtrit e Janjevës kanë qenë të njohur, madje i ftonin të punonin edhe në vende të tjera. Dhe prandaj ende qëndrojnë (qesh).

Erëmirë Krasniqi: Çfarë mjeshtër, a bën [të flisni] pak më shumë lidhur me këtë?

Omer Shkrijeli: Janjeva sipas mënyrës së jetesës dhe formës së organizimit kurrë nuk ka qenë fshat. Sepse sipas definicionit, ekonomistët e dijnë këtë më mirë, një vend është fshat nëse më shumë se pesëdhjetë për qind e popullsisë merret me bujqësi. Këtu askush nuk është marrur me bujqësi. Do të thotë kanë punuar me zanate të ndryshme, plastikë, metal, madje edhe këto punëdoret, pastaj ndërtimtaria, punimet nga druri, madje edhe paratë janë bërë një kohë, tregojnë më të moshuarit. Mua kjo nuk më kujtohet normalisht (qesh), kanë punuar këtu sepse, bazuar në origjinën e tyre, kanë qenë të angazhuar në këto punë që nga lashtësia.

Që kur kanë ardhur, sepse Janjeva është e vjetër më shumë se 300 vjet, në fakt më shumë se 700 vjet. Sepse kur në vitin 2003 ka qenë shtatëqind vjetori i Janjevës. Do të thotë në vitin 1303 u formua Janjeva. Dhe ajo u formua nga ata mjeshtrit e Dubrovnikut, përndryshe ata, me vet faktin që kanë ardhur, ata kanë ardhur si mjeshtër e jo si bujq. Dhe kështu zgjerohej trusti i tyre. Dhe këtu e keni një fenomen, ja të përmend diçka edhe historikisht, unë kam lexuar dhe kam biseduar me ata njerëzit e librit. Është një fenomen që shumica, që pakica e ka asimiluar shumicën. Ja sot qartësohen janjevasit dikush që ka qenë me prejardhje edhe serb apo shqiptar, ai tani nuk do të thotë që është diçka tjetër përveç janjevas katolik.

Sepse që ata të pranoheshin në atë çarshi. Në atë trustin ku bëhet puna kualitative, zanatet, prodhimi i metaleve të çmuara, ai është dashur ta pranoj edhe fenë edhe zakonet e atyre njerëzve. Kështu që ngadalë janë afruar shqiptarët e rrethinës, nga lartë serbët {lëviz duart} dhe sot e shihni edhe me mbiemra, të themi, nuk mund të jetë 'ajt unë tash vet po flas, ndoshta nuk jam edhe aq i kualifikuar. Të themi, të jetë Gjuriq apo Antiq ky janjevasi apo ku ta di këndeje, Rodiq apo tjetër që janë me prejardhje shqiptare, apo Pala këta Paliqët pastaj këta Burhani, Bikliqi e gjithë kjo ka qenë e përzier, kështu që edhe sot nëpër çarshi e thërrasin njëri tjetrin "kusho". (qesh)

⁴ Tjegulla nga dheu i pa pjekur, të terura në diell dhe të formuara me dorë; janë të pasura me baltë dhe shpesh janë bërë duke ju shtuar kashtë.

Edhe pse njëri ka mbetur musliman, ky shqiptari, ky tjetri ka kaluar në katolik ky janjevasi, por mirë, ata e dijnë që e kanë historinë e përbashkët, e kjo nuk i ka penguar askujt. Sepse është interesante, në kohën kur unë kam ardhur, kështu, të gjithë për shembull kanë folur në gjuhën turke, atë gjuhë e kanë pasur disi univerzale. Edhe kroatët kanë folur turqisht, edhe shqiptarët kanë folur turqisht, edhe romët ja pasi e përmenda, edhe romët mjaft janjevas kanë ditur të flasin në gjuhën rome. Do të thotë, nuk ka pasur komplekse. Sepse romët kanë qenë kryesisht punëtorë te ata dhe tani, e kanë pasur më lehtë të komunikojnë, mjaft biznesmen që e kanë pasur prodhimin e tyre, kanë ditur të flasin edhe në gjuhën rome.

Dhe kanë biseduar mirë me ta, kështu që, kjo i ka ofruar secilit njeri sikur unë që kam ardhur nga jashtë, një atmosferë shumë të këndshme. Që ju keni ardhur në një vend ku pa komplekse keni mundur të shprehni, e kjo është lehtësim për shpirtin. Kur dikush ua ndalon shprehjen, ju në fakt jeni të burgosur në kafaz (qesh). E kështu jeni *open mind* [anglisht - mendje hapur], mund të thoni çfarëdo, çkado që doni, të shprehni çka të doni, që askush të mos ua merr për të keq (qesh). Dhe kështu, kanë ardhur ato vitet e rënda, vitet e luftës. Ka filluar në Bosnje, Kroaci dhe pastaj kroatët papritmas kanë filluar të largohen që këtu. Praktikisht '91-'92 këto dy vite, tetëdhjetë përqind të janjevasve të atëhershëm kanë shkuar. Ka qenë...

Erëmirë Krasniqi: Mund të na thoni, a ka qenë këtu një miting, që disa serb kanë ardhur këtu?

Omer Shkrijeli: Paj po, këta ishin stimuj. Siç i thërras unë, stimuj. Vjen, shëtitet dhe nuk ka nevoj të thotë asgjë. Për shembull, Shesheli kur ka shëtitur nëpër Janjevë, ai nuk është dashur të thotë asgjë. Ai vetëm, është e mjaftueshme që ka qenë aty. Faktikisht, çka po prisni? në Kroaci po luftojmë, e ju po qëndroni këtu. Mendoj, kjo do të thotë në kuptim portativ. Kështu që, nuk është dashur ndonjë stimulim, njerëzit e kanë ditur këtë, e kanë ndjerë momentin. Në fund të fundit, janjevasit janë njerëz të botës, ata dijnë edhe vet ta vlerësojnë këtë situatë. Tjetër, edhe Kroacia e tyre ka qenë mjaft e interesuar kështu që ju ka siguruar vendbanimin. Kështu që ata nuk kanë shkuar atje në shator, por kanë shkuar tek vendbanimi i organizuar dhe që ju ka dhënë ato, krahët shtesë që lirisht kush ka menduar që nuk është për këtu, të shkoj.

Dhe këto kanë qenë ja, disi, interesat e plotësuara me një lëvizje edhe për serbët edhe kroatët e atëhershëm, ata t'i mbledhin njerëzit e tyre, këta ta lirojnë hapësirën. Që për fat të keq, pastaj kjo ka qenë si një lloj i politikës të qeverisjes së atëhershme në Serbi. Ta spastrojnë hapësirën, pastaj e dini edhe vet se çka ka ndodhur në vitet '98, '99 që edhe shqiptarët, jetën shqiptare kanë dashur ta spastrojnë nga ky vend dhe çfarë qëllimi kanë pasur në fund, një Zot e di, falë Zotit që nuk ka ndodhur. Që çdo njëri ka ardhur tek e vetja, që çdo njëri ka ardhur në shtëpinë e vet ta jetoj jetën e vet dhe, si të jep Zoti, që thonë (qesh).

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Herën e kaluar keni thënë që në Janjevë ka qenë, që Janjeva ka qenë shumë më e bukur se Prishtina?

Omer Shkrijeli: Po, po. Kështu, po flas nga aspekti i argëtimit dhe i relaksimit, ikjes nga problemet e përditshme. Normalisht që infrastruktura këtu nuk ka mundur të jetë më e mirë dhe nuk ka mundur të jetë komunikacioni e as shkollimi, dhe asnjë aspekt tjetër, por thjesht njeriu këtu ka mundur të gjej bash maksimalisht, vend për relaksim maksimal. Dhe t'i harroj ato streset që i ka përjetuar gjatë ditës, këtu ka qenë bash relaks. Sepse e para që ndoshta, nuk është rast në vendet e tjera, vini si i huaj, si i ardhur, dikush që nuk është vendas dhe askush të mos ua merr atë. Të jeni ashtu, të shikuar nga një kënd i veçantë por jo, keni qenë të mirë se ardhur.

Sikur po përpiqeshin që t'ju mirëpresin sa më mirë sikur të vinte dikush nga familja e tyre. Kjo ka qenë një mënyrë e sjelljes, le të themi, më kujtohet kur vija në Janjevë para se të filloja zyrtarisht të punoj. E dinin që isha pranuar për Janjevë, unë vija për shembull me shoqërinë time, pinim ndonjë pije. Aty nuk ka pasur shansë që të shkohet në shtëpi, aty janë shtyrë kush më shumë, jepni atje mysafirëve, jepni këtë, jo nëse kemi pirë pak më shumë, vetura mbetej aty te ata, ata na dërgonin në shtëpi. Nëse është çdo gjë okej, kështu që ka qenë bash ashtu, kënaqësi. Thjesht, jeni të mbushur me kënaqësi sepse e shihni që jeni në një rreth miqësor.

Pastaj aty kemi, atë dhe atë historinë disi e kemi prekur ato të '90-tat kanë sjellë ndryshime të mëdha, por ndryshime të mëdha për të keq. Sepse po të mos ishte ajo që ishte, Janjeva ka mundur të ngritet në një nivel më shumë. Do të thotë rinia ta përmirësoj tani atë edhe me momentin e ri sepse rinia ka filluar në Janjevë të arsimohet dhe të fitoj thirrje për shkollime të larta dhe ato zanatet e tyre t'i përmirësojnë, të sjellin teknologji të reja, kështu që sot Janjeva ka mundur të jetë shembull i ngjashëm me një, ndonjë pjesë veriore të Italisë e cila bash favorizon atë, atë zanatin e vogël, zanatet e vogla.

Por ka ndodhur një thyerje në shtet, thyerje në shoqëri, janë shpërbërë shumë struktura dhe me vetë këtë është shpërbërë edhe vet, edhe vet mënyra e jetesës. Është dashur të kalohet në disa të tjera, gjatësi të tjera të valëve, me thonjëza po them. Sepse ato vitet '90 kanë qenë kështu {telefoni cingëron} ashtu, në, karakteristike për atë se, keni pasur gjithmonë kërcënim prej diçka. Fillimisht mangësitë e mëdha, nëse nuk e bën këtë, nuk do të arrish për të marr as një kilogram sheqer as një litër vaj, as atë, as këtë. Shumë banorë kanë mbetur pa sigurim shëndetësor sepse i kanë lënë [pa mbrojtje shëndetsore], i kanë përzënë nga puna.

Ata zyrtarisht e kanë lënë, por ne e dijmë se si e kanë lënë [punën]. Dhe pastaj çfarë të bëni me ata njerëz, unë këtu i kam pasur 1200 shqiptarë pa mbrojtje shëndetësore në atë kohë dhe çfarë të bëj tjetër përveç ashtu, i pranoj, hesht, shko, gjindu për barna, çka tjetër. Dhe kjo ka mundur disi {telefoni

cingëron} të funksionoj, por vetëm përkohësisht. Pastaj me disa miq nga Prishtina jam bashkangjitur në disa organizata, organizata humanitare “Nënë Tereza” pastaj kemi filluar t’i sjellim disa barna esenciale nga ai kontigjenti humanitar, që është...

Erëmirë Krasniqi: Në cilin vit ka qenë kjo?

Omer Shkrijeli: Ka qenë ‘91, ‘92 këto dy vite kam qenë intenzivisht i kyçur në të. Madje edhe përmes kësaj dege në Lipjan, kjo ka qenë, e kemi hapur edhe një shtëpi shëndeti. Shoqata “Nënë Tereza” dhe të parët kemi filluar, ja ta lavdëroj edhe kolegun tim Murat Zejnullahun. Unë dhe ai kemi filluar të parët me punën në atë shtëpi shëndeti. Dhe pastaj kur edhe kolegët e tjerë e kanë parë që ajo është një gjë e mirë, edhe pse në fillim kemi pasur rezistencë dhe të shumtë kanë kaluar në ordinanca private dhe ju na merrni bukën e gojës ajo, kjo. Kur e kanë parë që ajo nuk është marrje e bukës së gojës por ndihmë për ato kategoritë e njerëzve më të rrezikuar, pastaj edhe ata janë bashkëngjitur për të ndihmuar. Kështu që kjo krijonte tani një imazh të ri {telefoni cingëron}.

[Intervista ndërprehet]

Dhe po e them këtë, ajo puna, puna humanitare disi e ka shënuar atë periudhën nga ato disa, ato dy, tri vite dhe më ka plotësuar të ju them të drejtën. Mua më së keqti më vinte kur vjen pacienti, e dëgjoni se si edhe fëmija i qanë e ju e, ju e shikoni, ju e shikoni e nuk keni çfarë t’i jepni. Kjo është një situatë e mjerueshme për një mjek. Sepse më shumë na plotëson sukcesi se sa vet paraja. Sepse badihava paraja nëse, nëse keni, nëse nuk keni sukses në, në punë. Dhe pastaj kjo është, kjo në një mënyrë më ka plotësuar. Unë në gjithë atë krizën, kur nuk ka pasur asgjë për t’iu dhënë, përnjëherë ke çfarë të jepësh. Dhe këtë ia jep atyre që më shumë iu nevojitet.

Erëmirë Krasniqi: Ju keni punuar edhe këtu edhe për “Nënë Terezën”?

Omer Shkrijeli: Po, e kam pasur një orar pune këtu pastaj pas orarit të punës në Lipjan shkoja te shtëpia e shëndetit “Nënë Tereza” dhe atje vazhdoja me këto aktivitete. Sepse njëra nga këto motrat e cila ka qenë e përgjegjshme për atë, me prejardhje është pikërisht nga Janjeva dhe pastaj oferta e parë mua më është dukur si ide e shkëlqyer dhe menjëherë e kam pranuar. Pastaj ka dalur që, që kjo ka qenë bash efektive dhe e mirë. Nga ajo periudhë disa kujtime janë plotësuar me disa emocione të përziëra. Së pari, përjeton zhgënjimin që ka kategori të njerëzve që nuk e dija që ekzistojnë, që menxi i kanë dy lecka në vete, aq shumë mjerim dhe varfëri dhe pyesni përnjëherë prej çka mund të jetojnë ata njerëzit. Nga ana tjetër, kënaqësia kur ata dalin me buzëqeshje, që kanë fituar diçka... (qanë) Dhe tani kjo po më, nuk kam fjalë...

Erëmirë Krasniqi: Ndoshta të flasim rreth familjes tuaj, si e keni nisur familjen tuaj këtu? Kur jeni martuar?

Omer Shkrijeli: Po i kam pasur atëherë, '88-tën, '89-tën e kam pasur një martesë. Gruaja ashtu, si çdo nuse dëshiron ta ketë, ta ketë pjesën e vet, këndin e saj të qetë, kjo edhe më ka shtyrë që ta zgjedh Janjevën si vendin ku do të jetoj dhe punoj. Pastaj diçka nuk ka shkuar si duhet, ka ardhur deri te ndarja, dhe tani jam i martuar me gruan time të dytë. E kam tanimë djalin dhe vajzën. Dhe ne ende jetojmë aty, gruaja punon në arsim, edhe ajo ndihet e plotësuar. E shoh, thotë fëmijët janë si janë por të paktën janë të dashur sepse kanë një mbështetje. Kështu që ai ambienti familjar ka ndikuar tek ajo që edhe ajo hajt të them t'i jepet fëmijëve. Pa atë, që thuhet, interes të fundit, po pikërisht të ju jep atë që ju nevojitet.

Erëmirë Krasniqi: Ajo punon këtu në Janjevë?

Omer Shkrijeli: Po, po, në Janjevë.

Anita Susuri: A është edhe ajo nga Janjeva?

Omer Shkrijeli: Jo, Jo, është njejtë nga vendi im. Kështu që ne jemi, edhe njëri edhe tjetri nga pak ndonjëherë me shpirt dhe traditë atje, e me punë këtu. Edhe pse tani, unë pyes si do të vendosnim (qesh) nëse dikush do të na ofronte a dëshirojmë andej apo këndeje, do të shohim. Me rëndësi është që tani po funksionojmë shumë mirë. Vajza ndërkohë u martua, djali është tashmë në fund të studimeve, edhe ai është mjek i ardhshëm. E të shohim...

Anita Susuri: Studion në Prishtinë?

Omer Shkrijeli: Jo, në Mitrovicë. Sepse, duhet në gjuhën amtare, edhe pse ai mjaft flet shqip por studimet janë pak *high level* [anglisht - nivel i lartë] që thonë, edhe për gjuhë edhe për të gjitha. Atje po i përfundon studimet pastaj shohim rreth angazhimit si do të jetë, por shpresoj që do të jetë mjek i mirë. Sepse e shoh që mund të diskutojmë për të gjitha, që jemi në një linjë të përbashkët dhe kështu...

Erëmirë Krasniqi: Pak të kthehemi te momenti kur janjevasit kroatë kanë filluar të shkojnë, a ju kujtohet kjo?

Omer Shkrijeli: Po, po, ja për shembull po e tregoj një anekdotë nga ajo kohë. Shkonin kamionët pas kamionëve, aty për shembull {tregon drejtimin} është shtëpia e atyre kroatëve që tani janë më të fuqishmit, të cilët kanë mbetur, është lart diku dyqind metra që këtu, e deri te posta kanë qenë të renditur kamionët dhe i kanë ngarkuar. Ka qenë shpërngulje masive, unë ashtu, vështirë tejkalohet ajo (qesh), për atë që nuk është janjevas.

Dhe tani, po vjen një grua e moshuar në vizitë dhe ashtu, si zakonisht, nuk ka ndonjë vështirësi të veçantë. Dhe unë i thashë, "Gjyshe, në çka po ankohesh, çka po të dhemb?" Thotë, "Po më dhembin

kamionët”. Thashë, “Të gjithëve na dhemb” (qesh). Do të thotë ka qenë, ka qenë atëherë edhe ajo diagnoza, po më dhembin kamionët. Dhemb me të vërtetë, kjo ka shkuar, kjo ka shkuar, rrint me mbrëmje me ta, pinit, shoqëroheshit, nesër e shihnit që nuk janë aty. Sepse vendimet janë marrë mbrenda natës. Sot thonin, “Nuk dojmë, s’kemi pse të shkojmë”. Dhe pastaj, ndodh diçka brenda natës, me siguri shkon një fqinj, shkon tjetri, pse të mbes unë, po shkoj edhe unë. Dhe kështu...

Erëmirë Krasniqi: Dhe çka ka ndodhur me pronat e të tyre?

Omer Shkrijeli: Pronat?

Erëmirë Krasniqi: Pronat, gjithashtu edhe me zanatet, pse kanë menduar që më nuk do të jenë këtu?

Omer Shkrijeli: Po ky është, ky është tani tregim në vete. Vet, vet lufta në Ballkan ju ka mbyllur atyre rrugët. Ata këtu kanë jetuar por fitimet i kanë pasur shumë më larg se këtu. Më së shumti në bregdet. Tani paramendoni ju që këtu duhet ta kaloni Malin e Zi, ndonjëherë edhe Bosnjën deri te Kroacia apo drejtë në Kroaci e aty në çdo vend ka qenë zonë e luftës. Do të thotë automatikisht ju është prerë, prerë ky, tregu ju është këputur. Pastaj janë orientuar në, në Shkup. Edhe pse ka pasur familje në Janjevë që kanë punuar ekskluzivisht me Shkupin pastaj kanë dashur edhe të tjerët.

Atëherë nuk ka pasur as për ata që kanë qenë më herët e lëre më për të rinjtë, pastaj edhe në Maqedoni gjendja u prish. Pra, shumica e njerëzve e panë se nuk ishte e mundur të punonin më këtu dhe pastaj nuk mund të kishin një punë tjetër. Pastaj diçka nga ato makinat i kanë shitur e diçka edhe kanë blerë atje, blenë të tjerë e të shumtët i kanë marrë që këtu. Kur i ngarkonin gjërat, i ngarkonin edhe makinat e tyre, ato kanë qenë mjaft të rënda por prej tyre kanë jetuar. Dhe e vazhdonin punën e tyre atje ku shkonin, por ka pasur edhe atëherë, një kategori e njerëzve është shpërngulur e cila ka qenë mjaft e varfër edhe këtu, të cilët kanë jetuar nga këta të pasurit. Këtu në nivel shumë të lartë është shprehur solidariteti.

Kush ka pasur, nuk, nuk është kursyer t’i ndihmojë atij që nuk ka. Kështu që, për shembull, ka qenë përulëse t’ia jepësh paratë në duar “Ja ku i ke” si lypësit. Por thotë, “A mund të mi dërgosh këto në shtëpi, kam blerë diçka?” Edhe pse e ka shtëpinë afër, nuk ka dhjetë, pesëdhjetë metra. Ai i merr, ai ia jep sa për një burek apo ku ta di, në vlerën e dy pijeve apo ku ta di. E dita është e gjatë, prej gjithkujt nga pak, në fund të ditës ai është mirë [financiarisht] mund të merr edhe në shtëpi diçka për familjen. Dhe kështu ka funksionuar. E ata kanë shkuar atje, në Kroaci dhe për këtë fillova të flas, në strehimet hajde të themi të detyrueshme, pastaj më vonë kjo ka kaluar në të përhershme.

Keni dëgjuar për këtë lagjen Kistanje? Kjo është poshtë në pjesën e Zarës kah deti, në rrethinën e Zarës. Më herët ka qenë e banuar me serbë, për shkak të operacioneve luftarake njerëzit janë zhvendosur. Pastaj ajo që shpesh manipulohet në media, [që ata] kanë hyrë në shtëpitë serbe. Po përkohësisht, e vërtetë por shumë shpejtë i kanë lëshuar ato shtëpitë serbe dhe kanë hyrë në shtëpitë

e sapo ndërtuara që Kroacia i ka ndërtuar atje në Kistanje. Kështu që për shembull, kur krahasojmë atë çfarë mediat manipulojnë me informacione, dhe kur shkoni, unë kam shkuar edhe t'i vizitoj atje, është tjetër fotografi.

Dihet publikisht, Kistanje ishte braktisur, për shembull, ato shtëpi serbe që kishin filluar të rrenoheshin, askush nuk i dëshiron ato. Nuk janë të tyre dhe nuk i duan, janjevasit janë të ndjeshëm për këtë, nuk i dojnë të huajat. Pastaj shteti Kroat ju ka ndarë një fushë në dalje të Kistanjes, dhe aty shtëpitë me ngjyra, ato si lagjja Marigona, njëra pas tjetrës (qesh), vetëm se nuk është ai kualitet i ndërtimit të shtëpisë. Pastaj ata ia dhanë çdo njërit nga një pjesë të parcelës dhe kështu ata nga ato shtëpitë e vjetra që ishin braktisur... ka pasur disa raste që i kanë blerë dhe i kanë marrë, pastaj kanë pasur edhe të drejta t'i përdorin në atë mënyrë, atje janë munduar ta organizojnë jetën sikur këtu në Janjevë.

Erëmirë Krasniqi: E si ndodhi që shkuat në vizitë?

Omer Shkrijeli: Po ka qenë nga pak pikëllim dhe gëzim, e dini. Sepse kjo ka ndodhur dhjetë vite pasi që janë larguar, 2003-tën kam qenë për herë të parë tek ata. Pastaj bash gati se i gjithë vendi është ngritur të, më ka ardhur shumë mirë t'i shoh sepse, këtu edhe kam punuar shumë me ta, sa kam mundur kam ndihmuar, dhe ata thonë që unë ju kam ndihmuar shumë më shumë se sa unë mendoj, por mirë. Tani është puna te vlerësimi personal.

Anita Susuri: E si e keni kaluar ju luftën? A keni qenë këtu?

Omer Shkrijeli: Po, po, kam punuar, vetëm ashtu kam mundur të mbijetoj. Sepse ka qenë shumë çështje e ndjeshme kur ai shteti, sido që të jetë ai, i vetmi shtet ka qenë në këtë hapësirë. Kur ju jepin detyrën ushtarake, ju e keni për detyrë të jeni aty ku jeni. E tani, a do të ju dërgojnë me uniformë apo jo, ajo punë është e rastit. E tani, unë kam qenë pak diplomat i mirë në atë rast, e kam pranuar detyrën civile, jo ushtarake. Kam të drejtë në këtë sipas ligjit. Dhe këto që i fola që kam qenë në disa shkolla të oficerëve, atëherë kam qenë në, dhe më është ofruar. Do të thotë askush nuk ka mundur të më ngreh pa pyetur sepse kam qenë dikushi, hajt të them një nivel më i lartë.

Pastaj e kam pranuar detyrën civile të jem nonstop në vendin tim të punës. Kështu që unë në kohën e luftës kam qenë në Lipjan. Do të thotë, praktikisht shtëpinë që e kam këtu afër as që e kam shfrytëzuar, sikur të mos e kisha afër shtëpinë, as që do e shihja (qesh). Përndryshe do të isha vet ashtu, në atë gjendje gatishmërie për të intervenuar nëse eventualisht ndodh ndonjë katastrofë më e madhe, që të mund të punoj dhe në fakt, atë periudhë prapë, e kam organizuar sipas mënyrës time, dhe i kam ndihmuar njerëzit. Edhe për atë që nuk ka qenë, në përshkrimin e punës. Pikërisht tani po më tregojnë disa njerëz, që ajo do të thotë shumë për ta, unë gati kam harruar.

Ju kam dërguar ilaçe të sëmurëve kronik në Hanrovc dhe Brus, dhe ata, sepse në atë kohë, nuk e di a ju kanë treguar të moshuarit. Ka qenë e ndaluar për shqiptarë të hyjnë në vendbanime, do të thotë në qytete. Ashtu njejtë edhe në Janjevë. Pastaj unë i kam pasur aty disa kroatë që ju jepja një qese me disa ilaçe dhe ata e kanë ditur se kujt t'ia dërgojnë. Edhe në Lipjan kemi punuar ashtu, sepse në hyrje të Lipjanit kanë qenë patrullat që i kthenin njerëzit. Madje edhe nga autobusi i nxjerrnin kanë qenë aty disa situata mjaft të vështira, të shkreta të cilat ju prekin si njeri pastaj jeni në dilemë, a duhet të punohet apo të, apo të mos punohet.

Por i kam pasur që thonë, prindërit si pengje atje, të bllokuar në shtëpinë e tyre, nëse do të gaboja unë, ata do ta paguanin (qesh). Pastaj thashë, është dashur ta bëj një kompromis që ta ruaj edhe shtëpinë, që ta ruaj edhe familjen dhe vet, me këtë rrugë e kam shfrytëzuar rastin t'i ndihmoj ata që kam mundur, çka tjetër.

Anita Susuri: A ka pasur ushtri këtu?

Omer Shkrijeli: Paj këtu jo edhe aq. Këtu më pak, e në Lipjan po. Këtu jo aq sepse ndoshta e kanë pasur një marrëveshje edhe me këtë, kishën lart, ky prifti janjevas ka qenë mjaft diplomat i mirë dhe ka ditur pak të balansoj me ta, që të mos i prekin. Nga ana tjetër, kur i kanë persekutuar disa grupe të shqiptarëve nga Hanrovci, Brusi dhe rrethina, ai i ka ruajtur në oborrin e kishës. Kështu që, pastaj edhe ushtria shqiptare e cila ka qenë në mal, nuk ka dashur ta prek Janjevën, kështu që... Kur nuk ka konflikte, atëherë janë njerëzit e qetë. Po të vinte deri te konflikti, të themi ushtritë e atëhershme dhe UÇK-ja këtu diku, me siguri populli do ta ndjente atë. Siç ka qenë për shembull në Slloveni apo ku ta di unë, e këtu jo.

Sepse as njëri e as tjetri nuk kanë dashur ta prishin një vend ku mund të vijnë kohë pas kohe të pushojnë (qesh). Kështu që këtë edhe e kanë bërë. Dhe disi, më së shumti në kujtim mbesin ato ngjarjet e mëdha, nuk kam shumë tregime nga jeta e përditshme sepse shpejt edhe u zhduk ajo jeta e thjeshtë. E gjithë ajo pastaj u bë e vështirë, e gjitha është bërë diplomaci e pastër, lufta për jetën sepse ai relaksi siç ka qenë atëherë kur kam ardhur të themi '89-ta, '90-ta, '91-ta. Ato tri vitet pastaj viti '91 kur ka filluar ajo shpërngulja e papritur. Ato tri vitet e para kanë qenë një tregim tjetër.

Vetëm kemi, kemi shikuar se kush është i lirë, ku do të mblidhemi që të relaksohemi. Për shembull kemi, hajt jemi mërzhitur, rinia, jemi, jemi mërzhitur aty. Ecim për kafe, ku, hajde thotë, në Selanik. Ja shkojmë, tri orë e gjysmë deri në Selanik. Pijmë kafe dhe kthehemi ja, ishte aq qetë, dhe kemi pasur (qesh) [para]. Këto kanë qenë disa ekstreme, kjo nuk ka qenë për çdo ditë por edhe ajo ka ndodhur.

Erëmirë Krasniqi: Sa i përket fesë dhe festave fetare?

Omer Shkrijeli: Aha, ajo, ajo jeta shpirtërore, feja, feja dhe jeta fetare këtu është në përputhje të shkëlqyeshme. Shkëlqyeshëm, në harmoni të shkëlqyeshme. Ju madje kur e shihni ja nga teraca e

shtëpisë së shëndetit, dhe e shihni një imazh të bukur, xhamia dhe kisha pothuajse në të njejtën vijë {shpjegon me duar} dhe është tolerancë aq e madhe sa që nuk është fare problem as për muslimanin të shkoj lart në kishë, tek ata të shoqërohen apo ata të vijnë poshtë. Ajo fare nuk është problem, kurrë nuk ka qenë e falë Zotit nuk është as sot. Ja njejtë, është rast i njejtë, ai është respekt i madh për fenë, ju mund të, të jeni katolik apo, apo musliman dhe askush për atë nuk do t'ju vlersoj apo shikoj ndryshe.

Sidomos te shqiptarët që e keni edhe njëerën edhe tjetrën fe. Do të thotë kemi familje me islam, familje me katolicizëm, madje i di edhe shumë martesë të përziera, të përziera sa i përket besimit (qesh). Kështu që kjo po funksionon, kjo po shkon.

Erëmirë Krasniqi: E si ka qenë pas luftës?

Omer Shkrijeli: Po edhe pas luftës ka pasur pak frikë, ka pasur frikë se njerëzit fillimisht nuk e kanë ditur çka do të ndodh, çka do të ndodh në përgjithësi dhe populli që është larguar kur të kthehen të gjithë, kjo është diçka në shpirtin e njerëzve, një inat që, që menjëherë të hakmerret. E çka do të ndodh, si do t'i shikojnë ata që kanë mbetur, t'i shpallin tradhtarë, mos po ndodh kështu. Pastaj njerëzit pak janë paqësuar, pak janë tërhequr. Deri sa nuk e kanë kuptuar që në fakt, dihet se kush është fajtor, dihet se me kë duhet të nevríkosemi. Madje edhe fqinjët serb, ata nuk ishin të gjithë në shënjestër. Mua më kujtohet që 2000-tën, madje edhe në 2001 kam parë në Graçanicë shqiptarët dhe serbët që pinin bashkë, pse jo.

Do të thotë është ditur se kush ka marrë pjesë në mënyrë aktive në ndonjë projekt, kush ka qenë jo njerëzor jo human, dhe është ditur kush i ka shikuar punët e veta, kush ka qenë i shtëpisë. Atë askush nuk e ka ngacmuar as nuk ka pasur në plan ta ngacmoj. Sepse në fund të fundit, mua më kujtohet shumë mirë si ka qenë rrugës Lipjan - Janjevë, kam ardhur për çdo ditë. Serbët janë të frikësuar, kishin të ngarkuara, vetura të ngarkuara, traktora me tesha që nëse duhet të ikin nga Kosova. Aty praktikisht “dy të çmendur”, unë po them “dy të çmendur”, me thonjëza. Sikur ta shkrepnin pushkën në mes të fshatit, të gjithë do të iknin, por ne, askush nuk e ka pasur atë plan.

Nuk ka qenë plani që njerëzit të dëboheshin në mënyrë globale, por preferonin të zgjedhin ngjarjet dhe objektivat për revanshizëm të caktuar. Por kurrë nuk kam qenë për revanshizëm. Unë, është njerëzore dhe nga Zoti e dhënë që të falim, e jo që të, që të hakmerremi.

Anita Susuri: A vijnë sot kroatët kur i kanë ato festat?

Omer Shkrijeli: Po, po, po. Por, gjithmonë e më pak, sepse gjenerata e vjetër po vdesin, e këta të rinjtë që kanë lindur në Kroaci, nuk po i tërheq edhe aq Janjeva, kështu që gjithnjë e më pak, por po vijnë, po vijnë.

Anita Susuri: Si është atmosfera kur ata vijnë?

Omer Shkrijeli: Po e mirë, e mirë, kryesisht na kujtohet shoqëria e dikurshme. Ajo është, ata prej lartë janë të pasur, kryesisht punojnë mirë e Kroacia është një vend i cili ofron më shumë se sa për shembull, ne në jug sepse sipas sipërfaqes është vend i madh ndërsa ka pak njerëz. Aty janë diku katër milion njerëz në, në hapësirën më të madhe, unë nuk e di, gati sa Serbia apo është aty diku me, me sipërfaqe. E, atëherë ka punë për të gjithë.

[Intervista ndërprehet]

Anita Susuri: A mund të na thoni, për shembull, sa njerëz do të thotë kroatë kanë punuar nëpër institucione këtu?

Omer Shkrijeli: Po me përqindje pak, me përqindje pak. Madje mund të numërohen me gishta, aty janë disa prej tyre, sepse... kanë qenë disa mësues, poshtë në ato organizatat e atëhershme partiake, komiteti, ajo kjo, kanë qenë të angazhuar dy, tre. Kështu që, praktikisht në gishta mund t'i numëroni kroatët që kanë punuar në sektorin publik. Kryesisht kanë qenë zanatlinj dhe sipërmarrës.

Erëmirë Krasniqi: A ka sot ndonjë industri, a ka mbetur diçka nga ajo jetë?

Omer Shkrijeli: Asgjë, asgjë, pak edhe kemi filluar me atë tregim, kur kam folur për atë se në biznesin e Janjevës kanë ndikuar operacionet e luftës, ka ndikuar një moment i ri që atëherë ka qenë i ri, tani më nuk është. Depërtimi i mallrave kineze. Juve nga Kina ju vjen malli, e përkryer në krahasim me atë që prodhohet këtu, me gjysmë çmimi. Kështu që vet produkti, materiali për prodhimin e një, një lodre, ata kryesisht i kanë prodhuar ato lodrat, ka kushtuar më shumë se sa lodra e gatshme nga Kina. Dhe kjo bash ashtu, i ka zbrapsur nga ky biznes.

Kështu që kanë mbetur vetëm ata të lënë, edhe ata gradualisht janë zhdukur sepse ai biznesi i vogël e ka humbur kuptimin. Për shembull, "Metaliku" është mbyllur dhe të gjithë partnerët e "Metalikut" ngadalë kanë rënë. Ata njerëz që kanë qenë zanatlinj dhe kanë punuar me metal, ata është dashur ta kenë një industri për vete, ku do t'i plasnin produktet e veta apo të punonin për disa sisteme të mëdha. Kjo përnjëherë ka shpërthyer dhe më nuk është punuar. Kështu që, tani, unë mendoj që është më keq, 98 për qind, lirisht mund të them, të janjevasve sot merret me tregti e jo me zanat.

Erëmirë Krasniqi: E si është qyteti sot, sa ju përket juve, si ka qenë, cili është kompozicioni i qytetit?

Omer Shkrijeli: Shikoni, nuk kam shumë lëvdata, do të jem i singertë. Sepse unë jam mësuar me një jetë qytetare, e ajo nuk është më. Tani është ai, sistem i jetës rurale. Sigurisht, probleme nuk ka, nuk ka aty ndonjë, madje nuk ka as pengesa kush dëshiron të organizohet si dëshiron por vet, vet biseda shkon në tjetër drejtim. Më herët është folur për gjëra tjera, sot flitet për tjera, e tani zona ime e

interesit nuk është ajo pjesë, për shembull, agroekonomia apo ku ta di (qesh) dhe pastaj nuk e gjej veten aty dhe gjithmonë e më rrallë, gati se nuk dal fare në kafene.

Erëmirë Krasniqi: E a ka kafene?

Omer Shkrijeli: Ka, ka, janë aty tri, katër të cilat janë aty afër dhe nuk e di, mendoj nuk ka në mahallë por kryesisht janë, në çarshi.

Anita Susuri: Vetëm ato kanë mbetur?

Omer Shkrijeli: Po, është njëra lart, ku janë, ku është pronar kroati dhe këto tri kafenetë ku janë pronar shqiptarët dhe... Këto janë ato që janë aktive.

Erëmirë Krasniqi: Okej. A keni diçka të shtoni, çfarë mendoni që do të ishte interesante?

Omer Shkrijeli: Që do të jetë interesante? Ku ta di, do të doja ndoshta të bëhet diçka për konzervimin e disa gjërave tipike. Të pakten, të pakten këtë arkitekturën do të doja të konzervohej, të pakten që është më afër qendrës. Ashtu, të ruhet një pamje autentike e vendit dhe të ketë kujdes për pastërti sepse, jemi të zhytur në mbeturina. Furnizimi me ujë është i parregulluar, sistemi i kanalizimit është ende në një gjendje të vështirë, kështu që kjo ndihet në ajër, veçanërisht verës.

Erëmirë Krasniqi: E a e dini, si është influencuar kjo arkitektura këtu në çarshinë tuaj?

Omer Shkrijeli: Paj, po them, fatmirësisht nuk është prishur shumë, nuk është prishur shumë në vet çarshi. E keni afër meje këtë objektin e ri. Këto tjerat janë objektet e adaptuara nga ajo kohë, kështu që është lehtë për konzervim, për konzervim. Nuk është, nuk është problem i madh që ajo të bëhet.

Erëmirë Krasniqi: Por a është arkitekturë tipike kroate apo? A është arkitekturë turke apo kroate?

Omer Shkrijeli: Paj të them unë do e, unë do e vlerësoja, unë do e vlerësoja që sipas arkitekturës është stili turk, sepse çarshia ka qenë turke, pa marrë parasysh që kanë jetuar kroatët. Sepse, bash e kam përmendur në një moment që kanë folur turqisht ata kroatët e vjetër. Forma e kulmit, ndërtesat që i kanë ndërtuar, kalldërma, e gjithë kjo frymon më atë Orientin... Përveç ndoshta ato, por edhe rrugët e ngushta janë pamje e orientit, nuk është vetëm, mirë disa, rrugët e ngushta i ka edhe Orienti. Kështu që aty, po mendoj, asgjë, asgjë nuk është tipike të themi vetëm e Janjevës por i gjeni ato edhe në.... Por ja unë ndoshta, është bukur që ekziston një vend i tillë në Kosovë dhe nuk e kam vërejtur që një vend tjetër ka diçka të ngjashme.